

Plani strategjik i hulumtimit 2017 – 2022

i

Akademisë “Evolucion”

Prishtinë

2016

Përmbajtja

1. Misioni dhe objektivat e Akademisë “Evolucion”	3
1.1 Misioni	3
1.2 Objektivat.....	3
1. Objektivat strategjike të hulumtimit në Akademinë “Evolucion”	4

1. Misioni dhe objektivat e Akademisë “Evolucion”

1.1 Misioni

Ne iu mundësojmë studentëve tanë të zhvillohen dhe të bëhen profesionistë të suksesshëm dhe pjesëtare aktivë e të dobishëm për komunitetin, përmes një procesi efikas të mësimdhënies, ushtrimeve praktike dhe projekteve hulumtuese e kreative në lëminë e arteve të aplikuara dhe dizajnit.

Këtë synim e arrijmë përmes zbatimit të teknikave dhe të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies si dhe komunikimit interaktiv midis studentëve stafit të Akademisë dhe akterëve të jashtëm.

1.2 Objektivat

Objektivat kryesore të Akademisë “Evolucion” janë:

- Të afirmohet si institucion i vlerësuar/respektuar i arsimit të lartë në Kosovë dhe dhe në vendet përreth, i njohur për zhvillimin dhe avancimin e ideve të reja krijuese, ideve shkencore dhe arsimimit të gjithmbarshëm;
- Të zhvillojë dhe të zgjerojë vazhdimisht veprimtarinë e vet mësimore në përputhje me standardet bashkëkohore në fushën e arsimit të lartë profesional;
- Të arrijë nivel sa më të lartë profesional të arsimimit të specialistëve në fushën e artit aplikativ, dizajnit, shkencës dhe kulturës nëpërmjet të një procesi të gjithanshëm të mësimdhënies, hulumtimeve, aktiviteteve artistike dhe projekteve kreative;
- T’i ofrojë tregut vendor dhe të rajonit profesionistë të kualifikuar në fushën e arteve të aplikuara dhe dizajnit në pajtim me zhvillimet ekonomike rajonale dhe më gjerë;
- Të ushtrojë veprimtari komerciale në lëminë e arteve të aplikuara dhe dizajnit;
- Të ndihmojë në avancimin dhe forcimin e pozitës së gruas në shoqëri;
- Të forcojë vetëdijen e përgjegjësisë sociale të stafit dhe studentëve dhe të vazhdojë të jetë kontribues i rëndësishëm në aktivitetet me interes të komunitetit.

1. Objektivat strategjike të hulumtimit në Akademinë “Evolucion”

Plani Strategjik i Hulumtimit 2017- 2022 ofron orientimin strategjik të hulumtimit për Akademinë "Evolucion" (AE). Plani Strategjik i Hulumtimit ka për qëllim të përafrohet dhe të lidhet me Planin Strategjik të AE 2015-2020

Misioni ynë i hulumtimit është të zhvillojmë një kulturë të gjallë dhe të qëndrueshme hulumtimi, që do të mbështesë procesin tonë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të frymëzojë studentët tanë, të mundësojë stafin akademik të arrijë përsosmëri dhe të përmirësojë pozicionin kombëtar dhe rajonal të Akademisë nëpërmjet kontributit që hulumtimi ynë i bën artit, kulturës dhe dobisë së komunitetit.

Gjatë pesë viteve të ardhshme, ne jemi të angazhuar për objektivat e mëposhtme kërkimore strategjike:

- Forcimi i mbështetjes së nevojshme për studentët dhe ligjëruesit për të dhënë rezultate me ndikim (impakt) të lartë;
- Avancimi i profilit dhe ndërgjegjësimit për sukseset hulumtuese në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Zhvillimi dhe zbatimi i proceseve, procedurave dhe mjeteve për të ndihmuar në sigurimin e zbatimit të planit strategjik të Akademisë.

Zbatimi i Planit të Kërkimit Strategjik përfshin katër elementët kryesorë në vijim:

- Komunikimi i Planit Strategjik të Hulumtimit stafit akademik dhe studentëve;
- Hartimi i Planeve të detajuara operative vjetore për mënyrën e realizimit të misionit dhe objektivave strategjike të hulumtimit;
- Zhvillimi i një numri matësish të suksesit për të ndjekur arritjet; dhe
- Raportimi për komunikimin e progresit dhe rezultateve për Bordin e Drejtorëve dhe komunitetin më të gjerë të Akademisë.

Objektivat dhe veprimet mbështetëse të përshkruara më poshtë janë përqendruar në ndikimin e hulumtimit, suksesin e studentëve dhe angazhimin e hulumtuesve tanë ndaj komunitetit.

Objektivi: Forcimi i mbështetjes së nevojshme për studentët dhe ligjëruesit për të dhënë rezultate me ndikim (impakt) të lartë;

Veprimet mbështetëse:

- Rritja e buxhetit për financim të hulumtimit;

- Nxitja e partneriteteve të reja kërkimore dhe mundësive për financim, (duke përfshirë industrinë), që janë të përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit;
- Rritja e mbështetjes institucionale kërkimore për shkrimin e granteve dhe administrimin e hulumtimit;
- Ribalancimi i ngarkesave mësimore, aty ku është e nevojshme, për të lejuar angazhim më të madh në hulumtime.

Objektivi: Avancimi i profilit dhe ndërgjegjësimin për sukseset hulumtuese në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;

Veprimet mbështetëse:

- Rritja e mbështetjes për paraqitjet publike të rezultateve të hulumtimit;
- Prezantimi i sukseseve të hulumtimit të AE brenda dhe jashtë;
- Krijimi i një strategjie të komunikimit të synuar për të përditësuar aktorët e AE, anëtarët e komunitetit dhe mediat mbi zhvillimet hulumtuese;
- Nxitja e zhvillimit të më shumë projekteve hulumtuese të bazuara në komunitet
- Përmirësimi i bashkëpunimeve hulumtuese me institucione të tjera (akademi, universitete dhe kolegje), si në Kosovë ashtu edhe në nivel ndërkombëtar;
- Sigurimi i burimeve të nevojshme për të publikuar sukseset tona hulumtuese.

Objektivi: Zhvillimi dhe zbatimi i proceseve, procedurave dhe mjeteve për të ndihmuar në sigurimin e zbatimit të planit strategjik të Akademisë

Veprimet mbështetëse:

- Komunikimi i Plani Strategjik të Hulumtimit me stafin akademik dhe studentët e AE;
- Zhvillimi i planeve vjetore operationale për të dhënë më shumë detaje se si do të arrihen misioni dhe qëllimet strategjike të hulumtimit;
- Zhvillimi një numri matësish suksesi për të demonstruar arritjet e hulumtimit;
- Raportimi mbi përparimin dhe rezultatet në Bordin e Drejtorëve dhe në komunitetin më të gjerë të Akademisë.

